

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Joint Stock Company
Trepça Deonitarsko Društvo

Nr. 5398 Data 11.06.2026
Mitrovicë Mitrovica



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deonitarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Në bazë të Ligjit nr.03/L-212 të Punës neni 8 dhe neni 10 paragrafi 2 nëparagrafi 2.2, nenit 22 paragrafi 4 i Statutit të Trepça Sh.A., nenit 8 paragrafi 2 të Rregullores për Marrëdhënie pune në Trepça Sh.A., si dhe bazuar në Rregulloren nr. 2778 të datës 26.05.2023 për Sistematizimin e Vendeve të Punës në Njësinë Biznesore Minierat me Flotacion Trepça Stantërg, Trepça Sh.A me datë 11.06.2026 publikon këtë:

Konkurs

Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Titulli i pozitës së punës:	Punëtor të kualifikuar në mirëmbajtjen e sillosave
Koeficienti/Paga:	760€ bruto
Nr. i kërkuar:	2
Kohëzgjatja e emërimit:	Në periudhë të caktuar (1 vjeçare me mundësi vazhdimi, puna provuese 6 muaj)
Data e njoftimit:	11.06.2026
Afati për aplikim:	12.06.2026 – 26.06.2026
Institucioni:	Ndërmarrja “Trepça Sh.A.”
Njësia Biznesore:	Miniera me Flotacion Trepça – Stan Tërg
Vendi i punës:	Flotacion

1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

- Zbaton urdhërat që i merr nga Brigadiri i mirëmbajtjes së sillosave dhe udhëheqësit tjerë përkatës;
- Bën punë të vazhdueshme në shembjen e xehes nëpër sillosa;
- Duhet të jetë i gatshëm për intervenim gjatë 24 orëve nëse paraqitet nevoja;
- Në disa raste është i obliguar të punoj në orar të pacaktuar;
- Obligohet t'i përdor mjetet mbrojtëse për vendin e punës dhe zbaton rregullat e mbrojtjes dhe sigurisë në punë;
- Angazhohet edhe në vende tjera të punës, sipas nevojës;
- Duhet të punoj edhe jashtë orarit të punës, sipas nevojës;
- Për zbatimin dhe mos zbatimin e detyrave të punës i nënshtrohet masave stimuluese dhe ndëshkuese, sipas rregullores së punës;
- të punës.

2. Kriteret e përgjithshme

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës;
- Të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara me ligj.

3. Kriteret e veçanta

- Të posedojë diplomë të shkollës së mesme të ulët;
- Duhet të ketë së paku 2 vite përvojë pune.

4. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit

- Aplikacioni (i cili shkarkohet online nga ueb-faqja e Trepça Sh.A.);
- Deklarata nën betim (e cila shkarkohet online nga ueb-faqja e Trepça Sh.A.);

- Dëshminë e përvojës së punës profesionale;
- Dëshmi nga gjykata kompetente që dëshmon se aplikuesi nuk është i dënuar për veprë penale apo nuk është nën hetime jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj;
- CV-Biografia;
- Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës;
- Kopjet e diplomave të noterizuara mbi kualifikimin arsimor dhe / ose nostrifikimin për diplomat jashtë vendit.

5. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- a. Testimi me shkrim- 100 pikë
- b. Intervista – 300 pikë

6. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes ueb faqes së ndërmarrjes “Trepça Sh.A.” në linkun <https://trepcasha.com/> , tek kategoria Shpallje.

7. Mënyra e aplikimit

- Dokumentacioni duhet të dorëzohet në zyrën e protokollit të Trepça Sh.A., në Menaxhmentin e Trepça Sh.A.- Parku Industrial Mitrovicë, çdo ditë pune nga ora 08:00- 16:00.

8. Shpallja e rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes ueb faqes së ndërmarrjes “Trepça Sh.A.”

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

